



Programi i lëndës “Etika në shëndetësi”	
Lëmi	Shëndetësi
Profili	Farmaci
Niveli	I
Klasa	Klasa 12
Fondi i orëve të lëndës:	35 javë x 1 orë/javë = 35 orë
Programi i hollësishëm i lëndës	
Kapitulli I: Parimet dhe teoritë e etikës	
a) Qëllimet e kapitullit	
Në përfundim të kapitullit nxënësi duhet të : <ul style="list-style-type: none">- Shpjegojë 4 parimet themelore të etikës mjekësore dhe teoritë etike- Përshkruajë njohurit për pëlqimin e informuar duke përfshirë edhe vlerësimin e aftësisë së pacientit për të gjykuar dhe marrë vendim të pavarur- Kuptojë rëndësinë e konfidencialitetit dhe rastet kur justifikohet thyerja e tij- Përshkruajë faktorët vlerësues të kompetencës për vendimmarrje të pacientit jo kompetent- Përshkruajë kriteret për zbulim dhe justifikimet për mbajtjen e informatave	
b) Temat e kapitullit	
<ul style="list-style-type: none">- Konfidenca, zbulimi i sekretit mjekësor- Veçoritë e raportit punëtor shëndetësor-pacient- Fillimi dhe ndërprerja e raportit punëtor shëndetësor-pacient- Pacienti dhe regjistrat mjekësorë	
c) Udhëzime didaktike për kapitullin	
Rekomandohet që mësuesi të: <ul style="list-style-type: none">- Shpjegojë përmbajtjen e lëndës dhe rëndësinë e saj- Ilustrojë ligjëratat me shembuj konkretë- Angazhojë nxënësit në grupe të vogla punuese- Zbatojë metodat bashkëkohore të ligjërimit	
d) Kushtet për realizimin e kapitullit	
<ul style="list-style-type: none">- Mjetet mësimore (vizatime, fotografi)- Mjetet bashkëkohore të teknologjisë informative (CD-programe)	
Kapitulli II: Problemet etike të përditshme	
a) Qëllimet e kapitullit	
Në përfundim të kapitullit nxënësi duhet të : <ul style="list-style-type: none">- Shpjegojë dallimet etike, morale dhe religjioze në lidhje me çështjet si: teknologjia riprodhuese, aborti, përcaktimi i gjinisë, kontracepcioni dhe kontrollimi i lindjeve- Përshkruajë problemet etike të lidhura me pacientë pediatrik dhe prindësi- Përshkruajë implikimet e mundshme të tejkallimit të raportit dhe marrëdhëniet profesionale me pacientë të gjinisë tjetër, pacientë paliativë dhe kolegë	
b) Temat e kapitullit	
<ul style="list-style-type: none">- Vendimi për riprodhim	

- Probleme të ndryshme etike
- Reziqet mjekësore për punëtorin shëndetësor dhe pacientin
- Trajtimet alternative
- Certifikimi i paaftësisë së pacientit
- Përgjegjësia profesionale
- Raporti seksual ndërmjet pacientit dhe punëtorit shëndetësor
- Kujdesi paliativ
- Etika e praktikës
- Punëtori shëndetësor dhe shoqëria
- Raporti me punëtorët tjerë shëndetësorë
- Hulumtimet

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- Shpjegojë përmbajtjen e lëndës dhe rëndësinë e saj
- Ilustrojë ligjëratat me shembuj konkretë
- Angazhojë nxënësit në grupe të vogla punuese
- Zbatojë metodat bashkëkohore të ligjërimit

d) Kushtet për realizimin e kapitullit:

- Mjetet mësimore (vizatime, fotografi)